

KONTRATË BINJAKËZIMI

**Përkrahje për Statistikat
Kosovë**



RAPORTI I MISIONIT

mbi

2.3.1.1 Vazhdimi i përkrahjes në implementimin e planit të veprimit

Komponenti nr. 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga

Clementina Ivan-Ungureanu, Søren Larsen dhe Timmi Graversen,
Statistikat e Danimarkës

11-14 Nëntor 2014

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +
Email: iu_clem@yahoo.com

Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk

Timmi Graversen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 38 65
Email: trg@dst.dk

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	6
2. Vlerësimet dhe rezultatet	6
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	121
Aneksi 1. Termat e Referencës	16
Aneksi 2. Personat e takuar	20

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Kombëtare Vjetore
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Nderkombëtar
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Objektivat kryesore të këtij misioni në kuadër të komponentit 2 – Llogaritë Kombëtare- të projektit të binjakëzimit, kanë qenë vlerësimi i situatës aktuale dhe azhurnimi i planit të veprimit, i përpiluar në fillim të projektit, në Janar të vitit 2014.

Në fushën e Llogarive Kombëtare, ASK-ja është e përfshirë në projektin multi-përfitues të IPA 2011 dhe është përfituese e asistencës teknike të FMN-së deri në Qershor të vitit 2014. Në projektin IPA 2011, ASK-ja ka dy objektiva kryesore: implementimin e ESA 2010 dhe implementimin e llogarive kombëtare në baza tremujore; asistenca teknike e FMN-së do të përkrahë përmirësimin e llogarive kombëtare vjetore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve, në çmimet aktuale dhe konstante.

Implementimi i ESA 2010 është fokusuar në vlerësimin e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), shpenzimeve ushtarake, outputin e Bankës Qendrore, aktivitetin e sigurimeve dhe distribuimin e FISIM, duke aplikuar metodologjinë e re. Këto vlerësime janë përfshirë në seritë kohore të rishikuara të BPV-së, për periudhën 2008-2012, sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, si dhe për vlerësimet e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 (të publikuara në Shtator të vitit 2014). FMN ka ofruar asistencë teknike për përmirësimin e llogarive kombëtare vjetore dhe rishikimin e serisë kohore 2008-2012. Rishikimi është fokusuar në vlerësimet: (i) outputit dhe konsumit të ndërmjetëm të njësive jo-financiare, bazuar në të dhënat e ASN-së; (ii) outputit të qeverisë (përfshirë metodën e re për Shpenzimet e Kapitalit Fiks SHKF kalkulimin), (iii) Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare (SHKFEF)), bazuar në qasjen e rrjedhës së mallrave; (iv) qeraja e përlllogaritur duke përdorur qasjen e shpenzimeve bazuar në të dhënat e ofruara nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; dhe (v) çmimet konstante të outputit të qeverisë dhe taksat mbi produktet. Të dhënat e rishikuara, krahas vlerësimeve për vitin 2013 të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve janë publikuar në Shtator të vitit 2014; BPV sipas qasjes së prodhimit për periudhën e njëjtë do të publikohet në fund të Nëntorit të vitit 2014.

ASK ka filluar kalkulimin e BPV-së tremujore (BPVT) në kuadër të kornizës së projektit IPA 2011, për periudhën 2010-2012; rezultatet, krahas vlerësimeve të vitit 2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014, do të publikohet në fillim të Dhjetorit të vitit 2014. Përmirësimet e mëtejme do të bëhen vitin e ardhshëm; ASK ka planifikuar të publikojë serinë kohore të rishikuar të BPVT-së (2010-2013), bazuar në të dhënat vjetore të rishikuara, në Qershor të vitit 2015, së bashku me vlerësimet tremujore të vitit 2014.

Është analizuar plani i punës për vitin 2015 duke marrë parasysh projektet në vazhdim dhe planet e ASK-së. Qëllimet e vendosura bazohen në planet aktuale dhe objektivat e binjakëzimit. Arritjet e tyre varen, jo vetëm nga zhvillimi i llogarive kombëtare, por edhe nga progresi në fushat e tjera statistikore, si statistikave strukturore dhe afatshkurta, çmimeve, statistikave sociale (Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare dhe Anketa e Fuqisë Punëtore) dhe qasjes në burime të të dhënave administrative. ASK ka nënshkruar në Qershor të vitit 2014 një Memorandum Mirëkuptimi me Administratën Tatimore, në mënyrë të sigurimit të të dhënave të detajuara të nevojshme për përpilimin e llogarive kombëtare. Të dhënat ofrohen në baza të rregullta, në mënyrë elektronike.

Plani i punës i hartuar në fillim të projektit ka qenë shumë ambicioz, por ASK ka zhvilluar aktivitet të qëndrueshëm dhe, duke pasë përkrahjen e projektit, një pjesë e konsiderueshme e objektivave të propozuara janë arritur. Plani i punës i zhvilluar për vitin 2015 merr në konsideratë rezultatet e arritura dhe objektivin operacional afatmesëm për Departamentin e Llogarive Kombëtare (DLLK), i cili ka për qëllim prodhimin në mënyrë të rregullt të Llogarive Kombëtare në përputhje me tabelën 1 të ESA 2010.

1. Komentet e përgjithshme

Raporti i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat e Kosovës'. Qëllimi i misioni ka qenë definimi i planit strategjik për zhvillimin e llogarive kombëtare në pjesën e dytë të projektit (viti 2015).

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Azhurnimi i planit të veprimit dhe asistimi i ASK-së në zgjerimin e planit të veprimit në një plan operativ afat-mesëm.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Stafi i llogarive kombëtare ka paraqitur gjendjen aktuale dhe e ka diskutuar atë me konsulentët gjatë ditëve të para të misionit.

Publikimi i fundit në webfaqen e ASK-së përfshin BPV sipas qasjes së shpenzimeve në çmime aktuale 2008-2013, në çmime konstante 2009-2012, BPV sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe çmime konstante 2006 - 2012. Megjithatë, Tabelat Ofruese-përdoruese (SUTs), prodhimi dhe gjenerimi i llogarive të të hyrave sipas sektorëve institucionalë për vitet 2005, 2006 dhe 2007 janë analizuar më parë por nuk janë bërë vlerësimet e azhurnuara.

Një përpilim i integruar dhe publikimi i BPV-së vjetore i bazuar në qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit si dhe Llogaritë Kombëtare Tremujore kanë filluar të jenë pjesë e planit të punës të KSS-së për vitin 2015, bazuar në progresin e arritur në kuadër të kornizës së projekteve të binjakëzimit dhe IPA 2011. Vlerësimet e para të BPVT-së sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, do të publikohen në fillim të Dhjetorit 2014; aktiviteti do të vazhdojë vitin e ardhshëm dhe në Qershor të vitit 2015 do të jetë i gatshëm versioni i parë i BPV-së vjetore 2014, si shumë e tremujoreve, sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve. Është paraparë të elaborohet dhe të publikohet versioni gjysëm-final i BPV-së vjetore për vitin 2014 sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në të njëjtën kohë, në Nëntor të vitit 2015.

2.1 Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2014

Plani i hartuar në fillim të projektit të binjakëzimit (Janar 2014) është prezantuar në tabelën 1.

-

[illegible]

Aktiviteti 1. Përmirësimi i Llogarive Kombëtare Vjetore

1.1 Implementimi i ESA 2010:

Kosova ka filluar implementimin e ESA 2010 vitin e kaluar, në kuadër të projektit IPA 2011. Harta rrugore për implementimin e metodologjisë së re është elaboruar dhe është në lidhje me:

- Kufirin e prodhimit: kërkimi dhe zhvillimi (R&D), FISIM, outputi i Bankës Qendrore, sigurimi jo-jetësor
- Asetet jo-financiare: sistemi i armëve.

Ndryshimet e tjera janë konsideruar ose jo relevante për ekonominë e Kosovës, ose, për shkak të burimeve njerëzore të kufizuara në ASK, implementimi i tyre nuk është i mundur në periudhën e ardhshme.

Vlerësimet në vijë me ESA 2010 janë realizuar për periudhën 2008-2012. Burimet e të dhënave që janë përdorur për vlerësimet dhe metodat e aplikuara janë prezantuar në detaje, në raportin e misionit të udhëhequr nga Clementina Ivan-Ungureanu në periudhën 9-13 Qershor të vitit 2014. Metodologjia e njetë është përdorur për vlerësimin e BPV-së 2013.

1.2 Rishikimi i Llogarive Kombëtare Vjetore- 2008-2012 (projekti i FMN-së) në të dy qasjet, çmimet aktuale dhe konstante, bazuar në ESA2010, NACE rev.1

Krahas implementimit të ESA 2010, ka filluar edhe rishikimi i të dhënave vjetore në kuadër të kornizës së projektit të FMN-së, për periudhën 2008-2012 sa i përket vlerësimit të: (i) outputit dhe konsumit të ndërmjetëm të njësive jo-financiare; (ii) outputit të qeverisë (përfshirë metodën e re për kalkulimin e SHKF), (iii) Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomisë Familjare (SHKFEF) (iv) qerasë së përlllogaritur/supozuar duke përdorur qasjen e kostos së përdoruesit bazuar në të dhënat e ofruara nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave dhe (v) outputit të qeverisë në çmime konstante dhe taksat në produkte. Metoda e kalkulimit të Shpenzimeve të Konsumit Final të Ekonomisë Familjare është ndërruar krejtësisht, duke kaluar nga vlerësimi i bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomisë Familjare në qasjen e qarkullimit të mallrave.

Rishikimi i serisë kohore të BPV 2008-2012 sipas shpenzimeve është publikuar në Shtator të vitit 2014 dhe sipas prodhimit në Nëntor të vitit 2014. I tërë rishikimi i BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, për periudhën 2008-2012 ka qenë shumë i vështirë, duke pasqyruar kohën e shkurtër të realizimit dhe burimet njerëzore në dispozicion. Të dhënat e reja kanë disa mospërputhje; janë dhënë disa rekomandime për përmirësime (Clementina Ivan-Ungureanu) gjatë misionit 1-5 Shtator të vitit 2014.

1.3 Shndërrimi në NACE rev.2 për BPV 2008-2012 (nëse tabela korresponduese është e gatshme në Qershor 2014)

Pjesë e transmetimit në ESA2010 është konvertimi i vlerësimeve të mëparshme të llogarive kombëtare në NACE rev. 2. Procesi i konvertimit në vetvete bëhet vetëm në anën e prodhimit dhe nuk duhet të ketë efekt në BPV-në dhe VSHB-në (Gross added value GVA) e përgjithshme. Kjo mund të përdoret si kontroll në kalkulime. Ky projekt mbështetet fuqishëm në shndërrimin midis NACE rev.1 dhe rev.2. ASK ka filluar procesin e implementimit të NACE rev.2 dy vjet më parë. Klasifikimi është analizuar dhe është përkthyer në gjuhën Shqipe. Është themeluar një grup pune me ekspertë nga ASK, Administrata Tatimore dhe

Agjencioni i Regjitrimit të Bizneseve të Kosovës (i cili është nën Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë), në mënyrë që të sigurohen kushtet për implementimin e klasifikimit të ri. Në vitin 2013, është mbajtur një anketë speciale për 27000 njësi, në mënyrë që të krijohet një tabelë korresponuese midis të klasifikimit aktual (NACE rev.1) dhe klasifikimit të ri. Bazuar në kushtet e vendit dhe rezultateve të anketës, është përpiluar një tabelë e përkohshme nga Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe ka qenë në dispozicion që nga Gushti i vitit 2014. Kjo tabelë konvertimi është përdorur nga DLLK për vlerësimin e outputit dhe konsumit të ndërmjetëm sipas aktivitetit të bazuar në NACE rev.2. Vlerësimet janë realizuar për periudhën 2008-2013 dhe do të jenë publike në fund të Nëntorit të vitit 2014.

1.4 BPV 2013 me qasjen e shpenzimeve bazuar në ESA 2010; publikimi i rezultateve

Plani i punës i elaboruar nga ASK për vitin 2014 ka parashikuar vlerësimin e BPV-së vjetore me qasjen e shpenzimeve, të gatshëm në Shtator, dhe me qasjen e prodhimit në Nëntor të vitit 2014.

BPV 2013 me qasjen e shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, është publikuar në Shtator të vitit 2014; vlerësimet janë bazuar në metodologjinë e ESA 2010.

1.5 BPV 2013 me qasjen e prodhimit bazuar në ESA 2010, NACE rev.2; publikimi i rezultateve

BPV për vitin 2013 me qasjen e prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante, bazuar në ESA 2010, duke përdorur NACE rev.2 do të publikohet në fund të Nëntorit të vitit 2014.

1.6 BPV 2014 me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, ESA 2010

Prodhimi i integruar dhe publikimi në të njëjtën kohë i BPV-së sipas shpenzimeve dhe prodhimit do të duhej të realizohej në vitin 2015. Plani i punës do të detajohet edhe më tej, duke marrë parasysh objektivat dhe rrethanat; rezultatet preliminare do të mund të publikoheshin në fund të Qershorit 2015 duke u bazuar në të dhënat tremujore, ndërsa një version i përkohshëm në Qershor 2015, nëse statistikatat e ASN-së do të jenë të gatshme me kohë.

Aktiviteti 2. BPV-ja tremujore

Në vitin 2014, ASK-ja ka punuar intensivisht për implemetimin e llogarive kombëtare tremujore. Ky aktivitet ka filluar në fillim të vitit 2013, në kuadër të programit multi-përfshirës IPA 2011. Procesi i implementimi ka filluar me vlerësimin e BPV-se tremujore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve për vitet 2010-2012, për të cilat kane qene të gatshme të dhënat vjetore.

Janë arritur objektivat kryesore të planit të punës dhe vlerësimet e para të BPVT-së për periudhën 2010-tremujori i parë 2014, duke u bazuar në metodologjinë ESA 2010, me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, do të diseminohen në Dhjetor 2014. Vlerësimet janë të bazuara në burimet e të dhënave administrative dhe statistikore në dispozicion dhe janë standardizuar me BPV-në vjetore.

Aktiviteti 3 – Përpunimi i Tabelave Ofruese-Përdoruese (SUT)

ASK-ja ka vlerësuar dhe publikuar SUT për vitet 2005-2007, në çmimet aktuale dhe konstante. Dy tabelat e para ofruese përdoruese janë përpunuar në kuadër të projektit IPA “

Përkrahje e mëtejme për Zyrën e Statistikave të Kosovës” i realizuar gjatë periudhës 2007-2009. Pas përfundimit të projektit, ASK-ja ka përpunuar SUT për vitin 2007 në çmimet aktuale dhe konstante, por ky aktivitet nuk ka vazhduar më pas. SUT paraqet një mjet të rëndësishëm për përmirësimin e llogarive kombëtare në baza tremujore dhe vjetore. Për këtë arsye duhet të merret në konsideratë që me përkrahjen e Projektit të Binjakëzimit të bëhet përpilimi i SUT për vitin 2013.

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN) përbën burimin kryesor të të dhënave për vlerësimin e llogarive kombëtare vjetore dhe mund të ofrojë informata për përpilimin e SUT. Është përmirësuar pyetësi i ASN-së për grumbullimin e të dhënave për 2013, në mënyrë që t’i përgjigjet nevojave të SUT.

Pjesa kryesore e aktivitetit SUT është planifikuar të zhvillohet në 2015.

Aktiviteti 4. Përmirësimi i metodologjisë dhe matjet statistikore të ekonomisë së pavrojtuar (NOE)

Në fund të vitit të kaluar, ASK-ja ka pasur përkrahjen e IPA 2011 në përpilimin e planit të veprimit për vlerësimin e ekonomisë së pavrojtuar duke u bazuar në qasjen tabelare të Eurostatit. Vlerësimi i llojeve të ekonomisë së pavrojtuar (N1 deri N6) varet nga burimet e të dhënave administrative dhe statistikore, që janë në dispozicion. Bazuar në këtë plan, ASK-ja është duke shikuar të gjejë përkrahje financiare nga donatorët për realizimin e këtyre anketave, por deri në fund të vitit nuk është bërë ndonjë progres në këtë drejtim; vlerësimet vjetore dhe tremujore të BPV-së përfshijnë çdo vlerësim të ekonomisë së pavrojtuar.

2.2 Plani i propozuar për aktivitetet në vitin 2015

Ndërlidhshmëria e projekteve në vazhdim (IPA 2012) dhe rezultatet e pritura janë diskutuar me stafin dhe menaxhmentin e DLLK-së dhe është propozuar plani operacional (tabela 2) i aktiviteteve për vitin 2015. Konsiderohet si plan real, i cili përfshin aktivitetet dhe objektivat e Departamentit të LLK-së, bazuar në burimet e të dhënave dhe burimeve njerëzore që janë në dispozicion.

Tabela 2 Plani operacional 2015

	2014				2015											
	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24		
	XI	XII	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		
Activity 1. Annual National Accounts improvement																
1.5 GDP 2013 by production based on ESA 2010, NACE rev.2 - publication	F															
1.6 Annual GDP improvement				S				F								
1.7 GDP 2014 by production and expenditure, ESA 2010, based on quarterly data								x								
1.8 GDP 2014 by production and expenditure- semi-final data										S			F			
Activity 2. QGDP																
2.4 Establishing QGDP estimation methodology (indicator method)	F															
2.5 Estimation of QGDP 2013 and IQ 2014 , production and expenditure, ESA2 010 current and constant, NACE rev.2	S	F														
2.6 Publication QGDP 2010-2013 and IQ 2014		x														
2.7 Revision QGDP 2008-2013 based on annual data improvement				S			F									
2.8 Q1-Q4 2014 , production and expenditure,current and constant, NACE rev.2				S			F									
2.9 Publication QGDP 2010-2014 - and maybe 2015Q1							F									
2.10 Current publication of QNA (2015q2-q3)							S				q2			q3		
Activity 3 - Elaboration of Supply and Use Tables (SUTs)																
3.1 Assessment of data sources and improvement in order to estimate SUTs																
3.2 SUTs in current prices for 2013																
3.3 SUTs for 2014 in current and constant prices																
Activity 4. Improve the methodology and the statistical measure of the non-observed economy (NOE)																
4.1 Illegal (drugs)																
4.2 Assessment of data sources for NOE estimation																
4.3 Estimation of NOE different types and its integration in National Accounts																

Aktiviteti 1 Përmirësimi i Llogarive Kombëtare Vjetore

1.7 BPV i vitit 2014 sipas prodhimit dhe shpenzimeve, ESA 2010, bazuar në të dhënat tremujore; 1.8 BPV i vitit 2014 sipas prodhimit dhe shpenzimeve – të dhënat-gjysëm-finale.

Në vitin 2014 si në të gjitha vitet e mëparshme, ka pasur një hapësirë kohore midis publikimit të BPV-së me qasjen e prodhimit dhe BPV-së me qasjen e shpenzimeve. Një nga objektivat e projektit të binjakëzimit do të jetë krijimi i kushteve për vlerësimin dhe publikimin e BPV-së vjetore me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, në të njëjtën kohë. Ky objektiv do të realizohet në vitin 2015; plani i punës për vitin e ardhshëm ka parashikuar publikimin e versionit të përkohshëm të BPV-së për vitin 2014 me qasjen e prodhimit dhe të shpenzimeve (si shumë e tremujoreve) në Qershor të vitit 2015 dhe versionin gjysëm-final në Nëntor të vitit 2015.

Përmirësimet e mëtejme të BPV-së vjetore do të bëhen në bazë të rekomandimeve të bëra gjatë misionit në vitin 2014. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN), në aspektin e cilësisë dhe afatit kohor, për qëllime të përdorimit për përpilimin e llogarive kombëtare.

Aktiviteti 2 BPV Tremujore

Plani i veprimit për vlerësimin dhe diseminimin e BPVT-së është diskutuar me menaxhmentin dhe stafin e Departamentit të LLogarive Kombëtare (DLLK). Këtë vit, ASK e ka si objektiv të diseminojë tremujorët II, III, dhe IV të vitit 2014 dhe dy tremujorët e parë të vitit 2015 (tremujori i I në Gusht dhe tremujori i II në Nëntor të vitit 2015). Pasi implementimi i BPV-së tremujore është i vështirë, është normale që ka pasur hapësirë midis publikimit të dhënave dhe periudhës referuese. Për dy tremujorët e parë të vitit 2015, vonesa është pothuajse 5 muaj, derisa rregulloret e Evropës mbi llogaritë kombëtare kërkojnë të diseminojnë të dhënat tremujore brenda 2 muajve pas përfundimit të periudhës përkatëse.

Aktiviteti 3 Elaborimi i Tabelave ofruese përdoruese (SUT)

Participantët e ASK-së kanë treguar interesim për krijimin e standardeve për tabelat ofruese përdoruese, për vitin 2013.

Ekspertët kanë prezantuar shembuj të matricave ofruese dhe përdoruese. Është demonstruar se si duhet të përdoren burime të ndryshme statistikore për të plotësuar pjesë të ndryshme të tabelës. Po ashtu është prezantuar se si mund të përshtatet korniza e SUT për të përfshirë më shumë ose më pak detaje, duke marrë parasysh të dhënat dhe burimet në dispozicion për përpilimin e tyre. Në fund është prezantuar se si mund të nxjerren lehtë të dhënat nga korniza e SUT. Megjithatë, është theksuar që krijimi i standardeve për SUT nga e para kërkon një angazhim më të madh se sa përpilimi i tabelave të ngjashme për vitet në vijim (ose paraprak).

Është cekur që sistemi i rrjedhës së mallit tashmë është përdorur për të bërë vlerësimin final për disa produkte dhe kjo mund të shihet si pikë nisje për sistemin-SUT. Megjithatë, besohet që mungojnë disa elemente të anës ofruese, sidomos në ato fusha ku ekziston aktiviteti joformal. Sistemi i ri do të kërkojë definimin e klasifikimit të plotë të produkteve, duke u bazuar në klasifikimin ndërkombëtar p.sh. CPA, por i agreguar në një numër të produkteve që mund të identifikohen në burimet e të dhënave të Kosovës. Klasifikimet e ngjashme të industrive, grupeve të konsumit dhe nëngrupeve të formimit të kapitalit duhet të zgjedhen në mënyrë që të marrin parasysh burimin e të dhënave në dispozicion.

Nëse 2013-ta është zgjedhur si vit për SUT, është e rëndësishme që të bazohet në rezultatet e një ankete industriale për vitin 2013 si dhe në anketën e re të bujqësisë, të cilat nuk do të jenë të gatshme deri në pjesën e dytë të vitit 2015.

Për SUT për vitin 2013 do të nevojten të dhëna nga ASN-ja për së paku:

- Vlerat të outputit total
- Konsumin e ndërmjetëm
- Kompensimin e punëtorëve

Për secilën industri që është paraqitur në kolona të SUT.

Zakonisht ASN mund të ofrojë shifra për:

- Hapjen dhe mbylljen e inventarit të materialeve, mallrave për rishitje, produkteve përfundimtare dhe punës në proces
- Formimi Bruto i Kapitalit Fiks (FBKF) sipas llojeve
- Blerja dhe shitja e mallrave për rishitje

Pyetësi i ASN-së për vitin 2013 tashmë është grumbulluar. Në lidhje me këtë, janë disa çështje, si:

- Një shkallë e ulët e përgjigjes në anketën e vitit 2013. Anketa është grumbulluar gjatë pushimeve verore.
- Procedura e zakonshme e validimit është shkurtuar, duke lënë shumë gabime për tu korrigjuar në mënyrë manuale
- Njësitë, ku nuk ka përgjigje në anketë, mund të identifikohen në regjistra administrative p.sh. regjistrin e TVSH-së.
- Njësitë joaktive duhet të përjashtohen.
- Të dhënat e detajuara për njësitë që mungojnë mund të gjenden në ASN për vitin 2012 ose 2014.
- Përndryshe, të dhënat mund të imputohen në bazë të njësive, që janë përgjigjur.
- Excel dhe Access për momentin janë të vetmet mjete për programim, që janë në dispozicion për këtë punë.

Mund të jetë e përshtatshme të shikohet për ndonjë asistencë në lidhje me planifikimin dhe/ose programimin e procedurave të validimit, si dhe të procedurave për ngritje në pesha, për të siguruar që rezultatet të jenë të gatshme kur të nevojiten për SUT.

Sistemi SUT kërkon definimin e klasifikimit të plotë për produktet, industritë, grupet e konsumit dhe nëngrupet e formimit të kapitalit. Ata duhet të zgjedhen në atë mënyrë që marrin parasysh burimin e të dhënave në dispozicion dhe preferohet të kenë një lidhje mirë të definuar me klasifikimet zyrtare ndërkombëtare p.sh. CPA, NACE, COICOP or COFOG.

- Planifikimi i një sistemi të ri mund të fillojë në fillim të pranverës 2015.
- Sapo të përcaktohen klasifikimet, mund të krijohet korniza ‘e zbrazët’ e SUT.
- Puna e vërtetë lidhur me SUT duhet të fillojë atëherë kur të jenë të gatshme rezultatet e ASN-së për vitin 2013.
- Është e domosdoshme që personat, që do të punojnë në SUT, të kenë kohën e nevojshme për këtë detyrë. Nuk është realiste të thuhet që puna me të dhënat do të fillojë para gjysmës së dytë të vitit 2015.
- Për futjen e të dhënave me siguri do të nevojiten dy misione + puna në mes të misioneve.
- Balancimi i balanceve të produkteve dhe balancimi final i marzhave të tregtisë, taksave dhe TVSH-së mund të kërkojë edhe dy misione tjera, por kërkesat e tilla natyrisht që varen nga madhësia dhe detajet e SUT, si dhe nga cilësia e të dhënave që fillimisht janë futur në sistem.

Një pasqyrë më e qartë mund të fitohet gjatë misionit të parë të planifikimit të këtij procesi.

Aktiviteti 4. Përmirësimi i metodologjisë dhe matjeve statistikore të ekonomisë së pa vërtetuar

Pasi në vitin 2014 nuk ka pasur aktivitete për vlerësimin e ekonomisë së pa vërtetuar, ky objektivi është transferuar për vitin 2015. Ekspertët e DLLK-së duhet të identifikojnë burimet e të dhënave në dispozicion dhe të grumbullojnë të dhënat që janë në dispozicion. Vlerësimi i ekonomisë së pavërtetuar duhet të fillojë këtë vit në mënyrë që të sigurohet përfshirja në llogaritë kombëtare dhe sidomos në SUT.

3. Konkluzionet dhe përfundimet

Rekomanduar që plani operativ i Departamentit të Llogarive Kombëtare të ndahet në komponente më të vogla dhe këto t'u caktohen punonjësve veç e veç. Poashtu rekomandohet përcjellja nga afër e zhvillimit të proceseve.

Rekomandohet të përmirësohen statistikat afatshkurta në kuptimin e përmbajtjes dhe afatit kohor të diseminimit, që të jenë në dispozicion dhe më të përdorshme për vlerësimin e llogarive kombëtare tremujore.

Rekomandohet që një mision në pranverë të vitit 2015 t'i dedikohet analizimit të mundësisë së përpilimit të SUT për vitin 2013. Gjatë këtij misioni mund të merren disa vendime mbi klasifikimin e produkteve, industrive, grupeve të konsumit dhe përdorimeve të tjera finale, që të përcaktojnë madhësinë e sistemit SUT. Nëse të dhënat e nevojshme nga ASN-ja dhe burimet e tjera do të jenë të gatshme me kohë, aktiviteti i përpilimit të SUT mund të realizohet në pjesën e dytë të vitit 2015.

.

Lista e qëllimeve të propozuara:

- i. Përmirësimi i BPV Vjetore
Afati: Qershor 2015
- ii. BPV 2014 sipas prodhimit dhe shpenzimeve - të dhënat gjysmë-finale. Afati: nëntor 2015
- iii. Rishikimi i BPVT 2008-2013 bazuar në përmirësimin e të dhënave vjetore
Afati: Maj 2015
- iv. Publikimi aktual i BPVT (2015q2-q3)
Afati: Shtator 2015; Dhjetor 2015

Rreziqet**Misionet e propozuara:**

- Rishikimi i BPVT 2008-2013 bazuar në përmirësimin e të dhënave vjetore (aktiviteti 2.7) LLKT: Përkrahja për të finalizuar të dhënat për 2010-2013, Iq2014, ESA95, NACE rev.2 (aktiviteti 2.5)
- LLKT : Përkrahja për të finalizuar tremujorët 2014 – (aktiviteti 2.8)
-
- Përkrahja për të përpiluar BPV vjetore 2014, sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve (aktiviteti 1.8)
- Përkrahja për të përpiluar SUTs (aktiviteti 3.1)

Aneksi 1. Termat e Referencës

**Projekti i Binjakëzimit i BE-së
KS12 IB ST 01
Përkrahje për Statistikat**

Termat e Referencës:**Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare****Aktiviteti 2.3.1.1: Vazhdimi i vlerësimit dhe azhurnimit të Planit të Veprimit****Afatet:****TeR –data e finalizimit: 27 Tetor 2014****Fillimi / fund i aktivitetit:****Gravesen and Larsen: 11-14 Nëntor 2014****Ivan-Ungureanu: 10-14 Nëntor 2014****Raportimi: 21 Nëntor 2014**

Rezultatet obligative të komponentit

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.3.1	Përkrahja fillestare e implementimit të Planit Veprues për Llogaritë Kombëtare Përkrahje e vazhdueshme e Planit veprues për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale e implementimit të Planit Veprues për Llogaritë Kombëtare	• Raporti i misionit i publikuar në faqen e internetit të projektit • Fushat e zgjedhura të Llogarive Kombëtar e të azhurnuar a sipas ESA2010	• Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit • Raporti i Misionit • Plani i veprimit, i azhurnuar	• Kapacitet i mjaftueshëm absorbimi • Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim • Staf i punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve • Qasje në statistika primare të qarta • Termat e references, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultat e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 2.3.1.1

Konsultimi dhe diskutimi me njësinë e Llogarive Kombëtare dhe Statistikave të Biznesit. Intervistat dhe bashkëpunimi me ekspertët e ASK-së nga Statistikat e Bizneseve dhe me ekspertin Virginia Balea që udhëheqë aktivitetin 3.2.1.2 Reduktimi final i prodhimit dhe përmirësimi i cilësisë së ASN-së (dy misionet janë caktuar brenda të njëjtës javë). Rishikimi i planeve për Llogaritë Kombëtare në Kosovë. Këshillimi i Llogarive Kombëtare në ASK mbi planin operacional për LLK në Kosovë

Në aktivitetin 2.1.1 (Clementina Ivan-Ungureanu dhe Timmi Graversen) të mbajtur në Janar 2014 është definuar një plan i detajuar veprimi për Llogaritë Kombëtare për vitin

2014 (shih tabelën 2). Plani i hartuar ka qenë ambicioz. ASK ka shqyrtuar planin dhe aktivitetet e nevojshme për të realizur përkushtimet afatgjata ndërkombëtare, në aspektin e nevojave të brendshme dhe në lidhje me donatorët dhe organizatat e jashtme, siç është Eurostat. Eurostat është i përkushtuar në realizimin e kombinimit ESA 2010 dhe NACE rev 2.

Disa planifikime fillestare për vitin 2015 janë të përfshira në raportin e misionit 2.1.1, por ky planifikim tani duhet të konfirmohet dhe /ose riorganizohet sipas asaj që në të vërtetë është realizuar në vitin 2014.

Raporti 2.1.1 identifikon 3 rreziqet e mëdha në hartën rrugore për Llogaritë Kombëtare në Kosovë: këto janë; I. Humbja e fokusit dhe shpërndarja e aktiviteteve në shumë subjekte, II. Ura/konvertimi midis NACE 1.1 dhe NACE 2 dhe, III. Mungesa e të dhënave tremujore. Ky aktivitet duhet të adresojë këto tre fusha me rrezik të madh duke analizuar gjendjen aktuale në të trijat.

Rezultate e pritura nga aktiviteti 2.1.1:

Raporti i misionit. Plani i veprimit i azhurnuar për llogaritë kombëtare në Kosovë, duke përfshirë planin operativ dhe planifikimin e aktiviteteve në këtë komponent. Këshilla se si të prioritetizohen veprimet relevante në fushën e Statistikave të Biznesit, në mënyrë që të sigurohet që të dhënat për Llogaritë Kombëtare të jenë në dispozicion në mënyrë të rregullt, cilësore dhe në kohën e duhur.

Gjendja aktuale e të gjitha elementeve të planit për vitin 2014

Plani i korrigjuar për vitin 2015

Vlerësimi i përgjithshëm i fizibilitetit të planeve të ASK-së për llogaritë kombëtare.

Resurset e ASK-së:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florijs Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florijs.Krap@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarite Kombetare,

Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Clementina Ivan-Ungureanu, Ekspert, Statistikat e Danimarkës,

iu_clem@yahoo.com

Mr Timmi Roelle Gravesen, Ekspert i Llogarive Kombëtare, Statistikat e Danimarkës,

trg@dst.dk

Mr Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Resurset e Projektit të Binjakëzimit:

Mr Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Ms Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK me mbështetjen e IPA përgatiti një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur 5 aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare:

Aktiviteti 2.1.1: Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të veprimit (Gravesen dhe Ivan-Ungureanu)

Aktiviteti 2.3.1.4: Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare me fokus në Llogaritë Kombëtare Tremujore (Ivan-Ungureanu)

Aktiviteti 2.2.1: Rishikimi i Llogarive kombëtare me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve (Ivan-Ungureanu)

Aktiviteti 2.3.1: Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare, me fokus në konvertimin NACE 2 (Ivan-Ungureanu)

Aktiviteti 2.2.1.1: Vazhdim i rishikimit të llogarive kombëtare vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve (Ivan-Ungureanu)

Projekti i Binjakëzimit do të ketë një aktivitet për azhurnimin e planit të veprimit dhe asistimin e ASK-së në zgjerimin e planit të veprimit në një plan operativ afatmesëm. Po ashtu misioni duhet të vlerësojë cilësinë e të dhënave prej Statistikave të Biznesit dhe burimeve tjera të jashtme që përdoren për prodhimin e Llogarive Kombëtare në ASK.

Aktivitetet që duhet ndërmerren si përgatitjet për misionin:

- Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global (AGA)
- Plan i Vjetor i Statistikave Zyrtare 2015
- Programi i Statistikave Zyrtare 2013 -2017
- Plan i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013
- Raportet e misionëve të kaluara mbi LLK (të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo)

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare.
- Zhvillimi i planit të detajuar për aktivitetet e Projektit të Binjakëzimit

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit per raportim
- Plani i detajuar për aktivitetet e tjera të Projektit të Binjakezimit në komponentin 2
- Versioni i azhurnuar i Planit të Veprimit të Llogarive Kombëtare – i gatshëm që të merret në konsideratë nga menaxhmenti i lartë i ASK-së

Aneksi 1. Programi, - Nëntor 2014

Dita	Vendi	Koha	Aktivitet
1	ASK	10:00	ASK: Rishikimi i aktiviteteve të përfunduara, që nga misioni i parë i LLK në Janar
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Planifikimi i javës
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Diskutimet mbi qasjet e ndryshme në të ardhmen për ASK-në
2	ASK	09:00-16:00	Seminar/diskutime (të kompletohet programi) Diskutime me Statistikat e Bizneseve dhe me Virginia Balea
3	ASK	09:00	Seminari/diskutimet vazhdojnë (të kompletohet programi)
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Diskutimet dhe rekomandimet
		12:00	Dreka
		13:30	Shkrimi i raportit
4	ASK	10:00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA
		10:30	Shkrimi i raportit

Aneksi 2. Personat e takuarASK:Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare,

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombetare

Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti

ASN dhe regjistri i bizneseve

Hysni Elshani, Shef sektori në Statistikat e Biznesit dhe Muhamet Kastrati, ekspert

RTA Team:

Per Knudsen, RTA (Resident Training Adviser)

Nora Zogaj, Asistente e RTA